

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6239  
E shtunë, 13 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

## Partitë mbyllin fushatën



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INSTITUCIONET E VENDIT KANË BËRË TË GJITHA PËRGATITJET  
PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE TË 14 SHKURTIT

# KOSOVA VOTON TË DIELËN PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME

## OPINION

JO NË ÇDO SITUATË QËLLIMI  
I ARSYETON MJETET,  
NË LUFTË PËR PUSHTET F. 11

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



GJILAN, FTOHEN QYTETARËT MBI  
MOSHËN 75-VJEÇARE TË  
REGJISTROHEN PËR MARRJEN E  
VAKSINËS KUNDËR COVIDIT F. 10

SHBA-ja SANKSIONON  
UDHËHEQËSIT E PUÇIT NË  
MIANMAR F. 2

## AKTUALE

ÇMIMET E KONSUMIT SHËNOJNË  
RRITJE PËR 0.5 PËR QIND F. 9

KEDS-I MOBILIZON  
MBI 1300 PUNËTORË  
PËR DITËN E ZGJEDHJEVE F. 9



## SPORT

KASTRATI: NA DUHEN FITORET  
PËR KUALIFIKIM F. 12

Qytetarët e Kosovës nesër (e diel) do të votojnë për herë të dytë brenda një periudhe dyvjeçare. Në zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit ata do t'u drejtohen kutive të votimit për ta zgjedhur legjislaturën e tetë pas rrëzimit të qeverisë Hoti nga Gjykata Kushtetuese në fund të vitit të kaluar. Të drejtë vote në këto zgjedhje do të kenë 1 milion e 794 mijë e 862 qytetarë, ndërsa institucionet e Kosovës i kanë bërë të gjitha përgatitjet për mbarëvajtjen e këtij procesi



## SIGURIMI SHËNDETËSOR PËR POLICËT, EDHE NJË PREMTIM I PAREALIZUAR

Në secilën palë zgjedhje partitë politike premtojnë sigurim shëndetësor dhe jetësor të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende

## PËR 24 ORË, GJASHTË TË VDEKUR DHE 372 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Kina ia ndalon transmetimin BBC-së

LONDËR, 12 SHKURT - Kanalit televiziv britanik BBC i është ndaluar transmetimi në Kinë, ka njoftuar Administrata Kombëtare për Radio dhe Televizion, përmes një deklarate më 11 shkurt. Ky njoftim ka ardhur një javë pasi rregullatori britanik i mediave i ka refuzuar televizionit shtetëror kinez licencën për transmetim. Përmbajtja e kanalit britanik ka

shkelur "seriozisht" udhëzimet për raportim në këtë shtet, duke përfshirë "kërkesat që lajmet të jenë të sakta dhe të vërteta", dhe të mos "dëmtojnë interesat kombëtare të Kinës", është thënë në deklaratë.

"Administrata Shtetërore për Film, Televizion dhe Radio nuk lejon BBC-në që ta vazhdojë transmetimin në Kinë dhe nuk pranon aplikimin vjetor për transmetim" është thënë në

njoftim. Një zëdhënëse e BBC-së ka thënë përmes një deklarate me shkrim se ky medium është i "zhgënjyer që autoritetet kineze kanë vendosur kështu".

"BBC është transmetuesi më i besuar i lajmeve në botë dhe raporton për tregime nga e gjithë bota në mënyrë të saktë, të paanshme dhe pa frikë apo favorizim", është thënë në koment.



## Mellburni hyn në izolim të ri, ndalohen turmat në Australian Open

MELBURN, 12 SHKURT - Shteti australian i Viktorias do të hyjë në izolim, për herë të tretë, për të shtypur një shpërthim të llojit britanik të koronavirusit, që besohet të ketë hyrë në komunitet nga një hotel karantinë. Zyrtarët australianë deri më tani kanë gjetur 13 raste që vijnë nga një punëtor, i cili pa dijeni është infektuar në një hotel në Mellburn. Izolimi ka nisur të enjten dhe do të përfundojë të mërkurën. Qeveria ka njoftuar se turneu

Australian Open i tenisit do të vazhdojë në kryeqytetin e shtetit, Mellburn.

Por, spektatorët do të ndalohen të marrin pjesë në ngjarjen e cila më parë ka tërhequr deri në 30 000 njerëz në ditë.

Kryeministri i Viktorias, Daniel Andrews, ka thënë se shpërthimi aktual i koronavirusit nuk është i lidhur me hotelet karantinë që përdorin lojtarët e tenisit. Ai ka theksuar se varianti britanik i koronavirusit përhapet më



shpejt dhe më lehtë, por shprehu bindjen se izolimi do të bëjë punë. Para këtij shpërthimi, Viktoria nuk ka pasur infeksione lokale për 28 ditë. Vitin e kaluar, në dimrin e Australisë, vendasit e Mellburnit kanë duruar një nga izolimet më të gjata dhe më të rrepta në botë, për ta luftuar valën e dytë të koronavirusit. Kjo valë ka shkaktuar më shumë se 90 për qind të 29 000 rasteve me koronavirus në Australi dhe 909 vdekje.

## ShBA-ja sanksionon udhëheqësit e puçit në Myanmar

UASHINGTON, 12 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka lëshuar një urdhër ekzekutiv për vendosjen e sanksioneve kundër udhëheqësve të puçit ushtarak në Myanmar. Sanksionet godasin dhjetë individë, përfshirë ushtruesin e detyrës së presidentit dhe tri kompani. Hapat u ndërmoren edhe për ta bllokuar qasjen e ushtrisë në një miliard dollarë fonde të Qeverisë së Mianmarit, që mbahen në ShBA. Ushtria e Mianmarit, vendit që ndryshe njihet edhe



si Birmani, ka organizuar puç më 1 shkurt, duke përmbytur qeverinë e zgjedhur në mënyrë

demokratike të Aung San Suu Kyisë.

Dhjetëra mijëra njerëz janë

duke protestuar tash e një javë, përkundër ndalimit të tubimeve të mëdha nga autoritetet dhe vendosjes së orës policore. Ka raporte për njerëz të plagosur rëndë, pasi policia përdori gazin lotsjellës, topat e ujit dhe plumbat e gomës kundër protestuesve. Presidenti Biden ka kërkuar zmbarsjen e puçit dhe lirin e udhëheqësve civilë, përfshirë Suu Kyinë. "Zërat e popullit të Birmanisë po dëgjohen dhe bota po shikon", ka pohuar Biden, duke u zotuar se do të ndërmerë veprime të

mëtejshme nëse është e nevojshme. "Do të vendosim kontrole të forta të eksporteve. Do ta ngrijmë pasurinë në ShBA, nga e cila përfiton qeveria birmaneze, ndërsa do ta vazhdojmë mbështetjen për kujdesin shëndetësor, grupet e shoqërisë civile dhe zonat e tjera, nga të cilat përfiton drejtpërdrejt populli i Birmanisë", ka deklaruar Biden. Kjo është hera e parë që Bideni përdor sanksionet prejse ka marrë detyrën e presidentit më 20 janar.

## Çekia i jep fund gjendjes së jashtëzakonshme

PRAGË, 12 SHKURT - Qeveria çeke humbi votimin në parlament për ta zgatur gjendjen e jashtëzakonshme për shkak të pandemisë së koronavirusit. Ligjvënësit e refuzuan kërkesën e kryeministrit Andrej Babis për ta zgatur gjendjen e tillë përtej 14 shkurtit, me gjithë paralajmërimet e tij për kolapsin e mundshëm të sistemit shëndetësor, për shkak të numrit të lartë të rasteve me koronavirus. Çekia, me 10.7 milionë banorë,

është nën nivele të ndryshme bllokimi qysh në tetor. Sipas Qendrës Evropiane për Kontrollin e Sëmundjeve, Çekia në dy javët e fundit ka qenë e dyta në Evropë, pas Portugalisë, sa iu përket rasteve ditore me koronavirus. Ky vend ka konfirmuar mbi 17 700 viktima me koronavirus, një nga normat më të larta në botë për kokë banori.

Numri i përgjithshëm i të infektuarve ka kaluar 1.6 milion. Mosvazhdimi i gjendjes së

jashtëzakonshme pritet të çojë në rihapjen e dyqaneve dhe heqjen e orës policore nga java e ardhshme. "Lehtësimi total dhe përhapja e pakontrolluar e infeksioneve, duke përfshirë mutacionet e reja të virusit, është rrugë drejt mbingarkimit të mëtejshëm të spitaleve dhe kolapsit të rrjetit spitalor", tha Babis.

Opozita në Parlamentin e Çekisë tha se qeveria po vepron në mënyrë kaotike dhe se ajo nuk i ka pranuar kërkesat për



një legjislacion të ri për pandeminë, për rishikimin e masave ekzistuese, për kompensim më të lartë për

sipërmarrësit dhe njerëzit në karantinë, si dhe për plane më të qarta për rihapjen e shkollave.

Flet për “Epokën e re”, Mërgim Lushtaku

# Pa PDK-në asnjë proces nuk ecën përpara



Kandidati për deputet i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Mërgim Lushtaku, ka bërë me dije se elektorati i PDK-së është mobilizuar si kurrë më parë për t'i dhënë fitoren kësaj partie më 14 shkurt. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se PDK-ja është e vetmja alternativë serioze në skenën politike, pa të cilën asnjë proces nuk ecën përpara. Lushtaku ka thënë se në udhëkryqin në të cilin ndodhet Kosova, vetëm PDK-ja di t'i japë drejtim. Sipas tij, qytetarët do të rreshtohen përkrah PDK-së ditën e zgjedhjeve edhe për shkak të padrejtësisë që u është bërë Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit

një frymë shumë më pozitive sesa në zgjedhjet e 6 tetorit.

**“Epoka e re”:** Është hera e parë që PDK-ja po shkon në zgjedhje duke mos pasur në Kosovë as liderin historik të saj, Hashim Thaçi, as liderin e dytë politik, Kadri Veseli. Sa sfiduese do të jenë këto zgjedhje për PDK-në?

**Lushtaku:** Është e vërtetë që jemi dëmtuar shumë pas goditjes që kemi marrë nga Gjykata Speciale me arrestimin e presidentit Thaçi dhe kryetarit Veseli, mirëpo ne përsëri kemi gjetur forcën që të mobilizohemi dhe të punojmë sa më shumë për hir të këtyre burrave që padrejtësisht qëndrojnë atje. Kam bindjen se edhe qytetarët e Republikës së Kosovës do të rreshtohen përkrah PDK-së në këto zgjedhje pikërisht për shkak të padrejtësisë që u është bërë dy liderëve të saj.

**“Epoka e re”:** Pse qytetarët duhet ta votojnë PDK-në?

**Lushtaku:** Qytetarët duhet ta votojnë PDK-në për disa arsye: PDK-ja ka program të qartë për rimëkëmbjen e Kosovës dhe në udhëkryqin në të cilin ndodhemi, vetëm PDK-ja di t'i japë drejtim. Pa PDK-në rrezikohet të shpërbëhet e gjithë ajo çfarë është arritur deri

më sot së bashku me aleatët tanë ndërkombëtarë si dhe pa PDK-në asnjë proces nuk ecën përpara dhe vendi vetëm stagnon dhe izolohet.

**“Epoka e re”:** Disa sondazhe janë publikuar deri më tani dhe PDK-në e nxjerrin parti të dytë. Cili është vlerësimi juaj për këto sondazhe?

**Lushtaku:** Nuk dua të merrem me sondazhe të tilla të cilat janë të paguara. Unë jam çdo ditë në terren dhe realiteti është krejtësisht ndryshe.

**“Epoka e re”:** Çfarë janë pritjet e juaja për zgjedhjet e 14 shkurtit? Sa mendoni se do të fitojë kjo parti?

**Lushtaku:** Në zgjedhjet e 14 shkurtit pres që PDK-ja t'i hedhë poshtë të gjitha sondazhet e paguara dhe të dalë e para. Qytetarët e Republikës së Kosovës do ta vlerësojnë lart opozitarizmin konstruktiv duke iu dalë në ndihmë në periudhën më të vështirë si pasojë e Covid-19, sepse PDK-ja ka qenë opozitë e pushtetit, por jo e shtetit dhe qytetarëve të saj. Andaj, mbi këtë bazë qytetarët do t'ia besojnë votën PDK-së si e vetmja alternativë serioze në skenën tonë politike.

**EPOKA ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 12 SHKURT** - Kandidati për deputet i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Mërgim Lushtaku, ka bërë me dije se më 14 shkurt elektorati i PDK-së do t'i hedhë poshtë të gjitha sondazhet e porositura. Ai është shprehur i bindur se PDK-ja do t'i fitojë këto zgjedhje dhe do të konfirmohet si parti e parë. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Lushtaku ka treguar se elektorati i PDK-së është mobilizuar si kurrë më parë. “Në zgjedhjet e 14 shkurtit pres që PDK-ja t'i hedhë poshtë të gjitha sondazhet e paguara dhe të dalë e para. Qytetarët e Republikës së Kosovës do ta vlerësojnë lart opozitarizmin konstruktiv duke iu dalë në ndihmë në periudhën më të vështirë si pasojë e Covid-

19, sepse PDK-ja ka qenë opozitë e pushtetit, por jo e shtetit dhe qytetarëve të saj. Andaj, mbi këtë bazë qytetarët do t'ia besojnë votën PDK-së si e vetmja alternativë serioze në skenën tonë politike”, ka thënë Lushtaku. Ai ka treguar arsyet pse qytetarët më 14 shkurt duhet ta votojnë PDK-në. Sipas tij, në udhëkryqin që gjendet Kosova, vetëm kjo parti mund t'i japë drejtim vendit. “Qytetarët duhet ta votojnë PDK-në për disa arsye: PDK-ja ka program të qartë për rimëkëmbjen e Kosovës dhe në udhëkryqin në të cilin ndodhemi, vetëm PDK-ja di t'i japë drejtim. Pa PDK-në rrezikohet të shpërbëhet e gjithë ajo çfarë është arritur deri më sot së bashku me aleatët tanë ndërkombëtarë si dhe pa PDK-në asnjë proces nuk ecën përpara dhe vendi vetëm stagnon dhe

izolohet”, ka thënë Lushtaku.

Ai ka folur edhe për ndikimin që do të ketë në këto zgjedhje mungesa e Hashim Thaçit dhe e Kadri Veselit. “Kam bindjen se edhe qytetarët e Republikës së Kosovës do të rreshtohen përkrah PDK-së në këto zgjedhje pikërisht për shkak të padrejtësisë që u është bërë dy liderëve të saj”, është shprehur Lushtaku.

**“Epoka e re”:** Z. Lushtaku, si ju ka shkuar fushata zgjedhore? Sa është mobilizuar elektorati i PDK-së për këto zgjedhje?

**Lushtaku:** Fushata zgjedhore është duke shkuar në mënyrë të mrekullueshme dhe kështu presim të shkojë deri në fund. Në bazë të asaj që kemi parë në terren, mund të them se elektorati i PDK-së është më i mobilizuar se kurrë dhe ekziston

## Certifikohen instruktorët e rinj të FSK-së

Prishtinë, 12 shkurt (ER) - Në Qendrën e Stërvitjes Bazë të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes janë certifikuar instruktorët e rinj bazuar në rishikimin e literaturës për misionin e ri të FSK-së, ka

bërë me dije Shërbimi i Përgjithshëm i FSK-së. “Instruktorëve të ri FSK-ja u ka besuar një detyrë të rëndësishme dhe me përgjegjësi trajnimitin e pjesëtarëve, që është çelësi

kryesor zhvillimor në të cilin mbështeten vlerat thelbësore si një element i rëndësishëm i ndërtimit dhe i themeleve të një karakteri ushtarak”, thuhet në njoftimin për media.





INSTITUCIONET E VENDIT KANË BËRË TË GJITHA PËRGATITJET PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE TË 14 SHKURTIT

# Kosova të dielën voton për zgjedhjet e jashtëzakonshme

Qytetarët e Kosovës nesër (e diel) do të votojnë për herë të dytë brenda një periudhe dyvjeçare. Në zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit ata do t'u drejtohen kutive të votimit për ta zgjedhur legjislaturën e tetë pas rrëzimit të qeverisë Hoti nga Gjykata Kushtetuese në fund të vitit të kaluar. Të drejtë vote në këto zgjedhje do të kenë 1 milion e 794 mijë e 862 qytetarë, ndërsa institucionet e Kosovës i kanë bërë të gjitha përgatitjet për mbarëvajtjen e këtij procesi

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 SHKURT - Nesër (e diel) qytetarët e Kosovës do t'u drejtohen kutive të votimit për ta zgjedhur legjislaturën e tetë. Institucionet e Kosovës kanë bërë të gjitha përgatitjet për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të parakohshme të 14 shkurtit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar

dizajnin dhe përmbajtjen e fletëvotimeve si dhe broshurën e kandidatëve të certifikuar për pjesëmarrje në këto zgjedhje. Të drejtë vote në këto zgjedhje kanë 1 milion e 794 mijë e 862 qytetarë. Në këto zgjedhje janë 143 mijë e 6 votues më pak se në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, pasi nga kjo listë janë larguar 122 mijë e 421 votues të cilët kanë vetëm dokumente të identifikimit të lëshuara nga

UNMIK-u si dhe për shkak të largimit të 11 086 personave të cilët janë konfirmuar se janë larguar nga skema pensionale për shkak të vdekjes. Numri i Qendrave të Votimit në të gjithë vendin është 888, me gjithsej 2 382 vendvotime. Po ashtu, sipas listës përfundimtare të certifikuar, është bërë me dije edhe për të dhënat e votuesve nga jashtë Kosovës, të cilët janë

regjistruar suksesshëm gjatë periudhës së aplikimit.

Gjatë periudhës së aplikimit KQZ-ja ka pranuar gjithsej 130 168 aplikacione për regjistrim. Pas vlerësimit të aplikacioneve janë aprovuar 102 100 aplikacione, ndërsa janë refuzuar 28 068 aplikacione. Gjithashtu, prokuroria dhe policia kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor më 14 shkurt. Këto institucione kanë bërë me dije se janë pajtuar që t'i bashkërendojnë aktivitetet e përbashkëta me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të votës.

Zyrtarët e këtyre institucioneve kanë deklaruar

se kushdo që cenon votën në ditën e zgjedhjeve do të përballet me forcën e ligjit. Për mbrojtjen e votës, Prokuroria ka caktuar 88 prokurorë, Këshilli Gjyqësori 30 gjyqtarë kujdestarë, ndërsa policia ka hartuar plan operativ për ditën e zgjedhjeve.

**Ministri Selimi takon Lumezin, diskutojnë për mbarëvajtjen e zgjedhjeve**

Ministri i Drejtësisë në detyrë, Selim Selimi, të premtën ka zhvilluar një takim pune me kryeprokurorin e shtetit, Aleksandër Lumezi. Në fokus të bashkëbisedimit gjatë këtij



mesin e serbëve të Kosovës në të kaluarën ka pasur presion dhe frikësime të kandidatëve dhe mbështetësve të cilët nuk ishin nga Lista Srpska, të cilën e mbështet Qeveria e Serbisë. “Opozita dinamike dhe një garë elektorale janë pjesë e demokracisë pluraliste”, është përgjigjur një zëdhënës i Komisionit Evropian. Komisioni Evropian edhe në Raportin e Progresit të miratuar vitin e kaluar kishte konstatuar se zgjedhjet në Kosovë ishin zhvilluar në përgjithësi në mënyrë të duhur me garë konstruktive, përpos në pjesët e Kosovës ku garonin pjesëtarët e serbëve të Kosovës.

### Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet trajnimin për votim përmes alfabetit Braille

Më 12 shkurt 2021 Misioni i OSBE-së ka përfunduar një seri prej pesë punëtorish me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës (ShVK) për t'i mbështetur votuesit e verbër dhe me shikim të dobësuar që të votojnë në mënyrë të pavarur në zgjedhjet parlamentare. Në këto punëtori u trajnuan rreth 1 300 votues të verbër dhe me shikim të dobësuar se si të votojnë përmes modelit të Braille-it, i siguruar nga Komisioni Qendror

i Zgjedhjeve. “Votimi është një nga instrumentet e llogaridhënies në duart e njerëzve. Në një shoqëri demokratike, votimi është edhe përgjegjësi. Prandaj, duhet të ekzistojnë të gjitha kushtet për t'i mundësuar çdo personi në listën e votuesve që ta hedhë votën e tij ose të saj, në mënyrë të pavarur dhe private”, u tha pjesëmarrësve të punëtorisë në Prishtinë, Kilian Wahl, ushtrues i detyrës i shefit të Misionit të OSBE-së në Kosovë. “Ne të gjithë duhet të mbajmë mend se çdo votë është e barabartë dhe çdo votë llogaritet. Prandaj, ju mund të bëni ndryshim”, ka thënë Wahl.

## Partitë mbyllin fushatën

Në ditën e fundit të fushatës subjektet politike i kanë mbyllur aktivitetet elektorale. Ato për dhjetë ditë rresht kanë prezantuar programet e tyre nëpër të gjitha komunat e Kosovës. Edhe në këto tubime gjithë kandidatët për kryeministër janë shprehur të bindur në fitoren e tyre.

Në takimin përmbyllës në Prishtinë, kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, është shprehur se ndryshimi që kanë kërkuar qytetarët nuk ka qenë kurrë më afër. “Pas 10 ditë fushate të jashtëzakonshme në këtë situatë të pazakontë, pas qindra takimeve me ju, nga çdo cep i Republikës, ndryshimi që keni kërkuar kurrë nuk ka qenë më afër. Këtë ndryshim e ka fuqizuar jashtëzakonisht shumë bashkëpunimi që kemi bërë: LV-ja dhe Lista Vjosa. Ne do ta realizojmë programin tonë Krejt dhe Drejt”, ka thënë Kurti.

Kurse kandidati për kryeministër nga PDK-ja, Enver Hoxhaj, ka publikuar një video emocionale në profilin e vet

në “Facebook”, ku ka treguar mbështetjen që ka marrë këto ditë të fushatës nga të gjithë simpatizantët e PDK-së. “PDK-ja e fortë e bën Kosovën më të fortë. Dilni dhe votoni më 14 shkurt! Votojeni Partinë Demokratike të Kosovës! Këtu e keni UÇK-në! Këtu e keni për atë që kanë luftuar Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli”, ka thënë Hoxhaj. Kandidati për kryeministër i LDK-së, Avdullah Hoti, ka mbajtur takim me banorët e Kodrës së Trimave në kryeqytet, ku ka theksuar se LDK-ja është e pamposhtur në këto zgjedhje. “Për dallim nga oponentët tanë, që ushqehen vetëm me demagogji, ne kemi program dhe projekte konkrete për ta çuar vendin përpara. Kemi Marrëveshjen e Uashingtonit që na i siguroi 1 miliard euro investime, që përfshijnë projekte të mëdha infrastrukturore, mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, investime në energjetikë e shumë të tjera”, ka thënë Hoti.

Në ditën e fundit të fushatës

zyrtare për zgjedhjet e 14 shkurtit, kandidati për president nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka qëndruar në Lipjan. Nga atje Haradinaj u zotua se do të angazhohet fuqishëm të ndërtojë një Kosovë të fortë, të sigurt me një ekonomi të qëndrueshme. “Në Lipjan u zotova se do të angazhohem fuqishëm që ta ndërtojmë një Kosovë të fortë e të sigurt, me një ekonomi të qëndrueshme që garanton një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Ndërkaq lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se kauza e tyre “Me Çlirimtarët” ka marrë përkrahje të madhe në gjithë Kosovën. “Bashkëluftëtarët e mbështetësit tanë të shumtë kudo nëpër Kosovë, si kurrë më parë, janë rreshtuar krah frymës sonë dhe kanë vendosur që më 14 shkurt të votojnë për numrin 121, për një zë të fuqishëm të vlerës së UÇK-së në Kuvendin e Kosovës”, ka thënë Limaj.



takimi ishte mbarëvajtja e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 14 shkurt. Duke konsideruar se Kosova është e dëshmuar për zgjedhje të lira dhe fer, si shtyllë e demokracisë funksionale dhe shembull për shumë shtete të rajonit, ministri Selimi ka potencuar se duhet ruajtur këtë pjekuri elektorale dhe përgjegjësinë e manifestuar të qytetarëve gjatë procesit zgjedhor. Në kuadër të takimit, ministri Selimi ka bërë thirrje që komisionarët dhe vëzhguesit t'u përmbahen principeve të administrimit të procesit të votimit dhe numërimit në mënyrë që të sigurojnë integritet të kutisë së votimit, duke garantuar proces transparent e kredibil, po ashtu që të mos bëhen pre e kryerjes së veprës penale të mashtrimit në votime, vepër kjo që është e dënueshme deri në pesë vjet burgim. “Komisionarët dhe vëzhguesit janë gardianë dhe garantues të ruajtjes së votës së lirë dhe, si të tillë, duhet të jenë

përgjegjës që vota e secilit qytetar të shkojë në destinacion, duke siguruar proces të drejtë zgjedhor”, ka thënë Selimi.

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka deklaruar se Prokuroria e Shtetit është adresë për raportim të çfarëdo rasti të kundërligjshëm, duke thënë se të gjitha keqpërdorimet do të ndiqen dhe ndëshkohen sipas ligjit.

### BE-ja pret proces transparent zgjedhor në Kosovë

Bashkimi Evropian pret që zgjedhjet e 14 shkurtit në Kosovë të organizohen në mënyrë të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe transparente në gjithë territorin e Kosovës, përfshirë edhe në mjediset ku kandidojnë pjesëtarët e komunitetit serb. Këtë porosi BE-ja e ka dhënë duke u përgjigjur në pyetjet rreth vërejtjeve të mëhershme se në

# Sigurimi shëndetësor për policët, edhe një premtim i parealizuar



**Në secilën palë zgjedhje partitë politike premtojnë sigurim shëndetësor dhe jetësor të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende**

**PRISHTINË, 12 SHKURT** - Pjesëtari i Policisë së Kosovës, Shaban Tasholli, thotë se u infektua me Covid-19 gjatë orarit të punës. Shërimi i tij i kushtoi rreth 2 000 euro. Në mungesë të një sigurimi shëndetësor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, Tasholli u detyrua që të paguajë vetë për shërim. “Në orar të punës kam qenë kur jam infektuar. Bile kam qenë duke u përgatitur për një intervistë dhe kam pasur vështirësi edhe për dhënie të intervistës dhe të nesërmen kam hyrë në spital. Unë kam pasur Covid, por ‘Covid-i im’ ka kushtuar 1 700 euro. Edhe nuk jam paguar për atë shërim”, shprehet Tasholli, i cili është edhe kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës.

Në secilën palë zgjedhje partitë politike premtojnë për sigurim shëndetësor dhe jetësor të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende. “Të gjitha qeveritë deri më tani kanë premtuar, por premtimet e tyre kanë qenë të kota”, thotë Tasholli.

Sidoqoftë, në mungesë të një

politike për sigurimin shëndetësor dhe jetësor të nëntë mijë policëve, Policia e Kosovës ka gjetur një alternativë.

Nëpërmjet një përgjigje me shkrim nga Zyra e Informimit e Policisë së Kosovës të dhënë për “Radion Evropë e Lirë”, edhe pse nuk ka sigurim shëndetësor për punonjësit policorë të lënduar në detyrë, ata kanë përkrahje shëndetësore. “Për çdo lëndim në detyrë, në rast se nuk ka trajtim në Kosovë, Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore përcjell kërkesën për trajtim jashtë vendit në Ministri të Shëndetësisë. Nëse kërkesa aprovohet nga Ministria e Shëndetësisë, ministria mbulon shpenzimet e trajtimit, kurse pjesa e mbetur financohet nga PK-ja (nëse e lejon buxheti). Nëse kërkesa nuk aprovohet për shërim jashtë vendit nga Ministria e Shëndetësisë, PK-ja mbulon shpenzimet e trajtimit mjekësor për trajtim jashtë vendit (nëse lejon buxheti i PK-së)”, thuhet në përgjigjen dhënë për REL-in. Drejtori Ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami

Mazreku, tregon se që nga viti 2018 gjatë takimeve me Policinë e Kosovës është formuar një grup punues me të gjitha kompanitë e sigurimeve dhe është prezantuar një raport ku parashiheshin tri pako të ndryshme të sigurimeve. Madje aty është paraparë edhe çmimi që do t’i kushtonte buxhetit të Kosovës. “Shuma vjetore ishte 3.7 deri në 4 milionë euro për 9 mijë policë sa janë në Kosovë. Ky fond ka qenë për dy polica, edhe për sigurimin jetësor dhe shëndetësor”, thotë Mazreku. Sipas tij, dokument-propozimi është dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në komisione parlamentare dhe në qeveri. “Unë e kam parë që nuk ka pasur vullnet politik që dikush të merret me këtë punë”, thotë ai.

Mazreku gjykon që një prej arsyeve pse nuk ka pasur vullnet politik për ta realizuar sigurimin shëndetësor e jetësor të policëve është se partitë kanë pritur që të kalojë Ligji për Sigurimin Shëndetësor Publik e në këtë mënyrë të sigurohen edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Por, Ligji për sigurime shëndetësore është miratuar në vitin 2014 nga Kuvendi i Kosovës, por asnjëherë nuk është zbatuar.

Sipas kreut të Federatës së Shëndetësisë së Kosovës, Blerim Syla, në Kosovë ende nuk janë plotësuar të gjitha parakushtet që të zbatohet Ligji për sigurimet shëndetësore. Syla gjykon që ky është një proces i gjatë dhe që së pari

duhet të bëhet sistemi informativ shëndetësor që kërkon shumë përkushtim nga qeveria. “Ky ligj ka kaluar në vija të trasha. Ai ka kaluar si ka kaluar, pa u kalkuluar mirë të gjitha dhe pa një diskutim në një debat publik. Nuk e kemi një sistem informativ i cili kërkon kohë jashtëzakonisht të madhe. Nuk e kemi një ligj të protokolleve, një ligj të sëmundjeve etj”, sqaron Syla. Sipas tij, Ligji për Sigurimin Shëndetësor kërkon kohë për t’u zbatuar. “Nuk është Ligji i sigurimeve shëndetësore ai që bëhet vetvetiu, pa qenë të implikuara të gjitha ministratë. Në këtë rast vetëm Ministria e Shëndetësisë nuk mund ta bëjë këtë. Janë edhe ministratë e tjera, pra parakushtet, të cilat kërkohen minimumi nëse fillohet sot i duhen dy vjet, e pas dy vjetësh mund të flasim për fillimin e implementimit”, thekson Syla. Federata që udhëhiqet nga Syla iu është adresuar partive politike lidhur me mënyrën se si mendojnë që ta realizojnë këtë politikë, pasi ai gjykon që disa parti premtimin për sigurime shëndetësore nuk e kanë ndryshuar nga zgjedhjet e vitit 2019. “Çdo premtim elektoral, i cili sot del, thuhet se do të bëhet brenda këtij mandati, e unë mendoj që është premtim bosh”, shton ai.


Pikërisht për shkak të mungesës së një ligji për sigurime shëndetësore, kreu i Byrosë për Sigurime Shëndetësore, Mazreku, thotë se ata kanë

menduar alternativën se si policët të kenë sigurim shëndetësor dhe jetësor. “Ne u kemi thënë ndani fondet për atë kohë sa ju mendoni që Ligji për sigurime publike nuk do të hyjë në fuqi”, thekson Mazreku.

Deri më tani, sipas Mazrekut, asnjë parti nuk ka kontaktuar me Byronë për Sigurime Shëndetësore për të marrë më shumë informata lidhur me çështjen e sigurimeve shëndetësore në përgjithësi dhe sigurimit shëndetësor e jetësor për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Ndonëse asnjë parti nuk ka kërkuar informata në Byronë për Sigurime Shëndetësore, partitë në programet e tyre e parashohin sigurimin shëndetësor.

Në planin për shëndetësi nga Lëvizja Vetëvendosje thuhet që: “Funksionalizimi i sigurimeve shëndetësore publike është detyrë jona, për të cilën zotohem para jush se do të përmbushet”. Gjithashtu, veçmas nga sigurimet shëndetësore publike, Vetëvendosja në planin për Sigurime Publike parashihet edhe sigurim shëndetësor e jetësor për policët. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës në prioritetet dhe parimet në shëndetësi në pikën e katërt parashihet sigurimet shëndetësore. Kurse Partia Demokratike e Kosovës në planin për rimëkëmbje të shëndetësisë ka plan që sigurimet shëndetësore t’i realizojë brenda tremujorit të parë të qeverisjes së saj.

# Për 24 orë, gjashtë të vdekur dhe 372 raste të reja me Covid në Kosovë

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 SHKURT - Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të premten 372 persona të infektuar me Covid-19, pas testimit të 2 856 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar gjashtë viktima me këtë virus. "Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prizren 3 raste (54, 70, 83 vjeç), Ferizaj 1 rast (77 vjeç), Kaçanik 1 rast (87 vjeç) dhe Prishtinë 1 rast (83 vjeç)", është thënë në njoftim. Sipas IKShPK-së, nga Covid-19 të premten janë shëruar 333 persona, kurse raste aktive janë 7 041. Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para me koronavirus në Kosovë, autoritetet shëndetësore në këtë shtet kanë regjistruar 63 805 persona të infektuar me këtë virus. Prej tyre, 1 540 pacientë kanë vdekur.

## Rastet pozitive për 24 orët e fundit janë nga këto komuna

Prishtinë 156 raste, Prizren 33 raste, Pejë 32 raste, Gjakovë 16 raste, Lipjan 14 raste, Obiliq 14 raste, Fushë-Kosovë 13 raste, Istog 10 raste, Mitrovicë 9 raste, Suharekë 9 raste, Deçan 8 raste, Gjilan 8 raste, Ferizaj 7 raste, Podujevë 6 raste, Klinë 5 raste, Vushtrri 5 raste, Dragash 4 raste, Graçanicë 4 raste, Kaçanik 3 raste, Rahovec 3 raste, Drenas 2 raste, Kamenicë 2 raste, Shtime 2 raste, Skenderaj 2 raste, Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Junik, Malishevë dhe Novobërdë.

## Nuk ka rregulla të reja për diasporën, vendimi për testin PCR është i para disa muajve

Ministria e Shëndetësisë ka dhënë një sqarim për qytetarët,

se vendimi për diasporën për testin PCR për Covid-19 është marrë para disa muajsh dhe nuk ka ndryshuar asgjë sa i përket këtij vendimi. MSh-ja përmes një reagimi thotë se shpreh keqardhjen për manipulim e opinionit nga individë të papërgjegjshëm. "Ministria e Shëndetësisë shpreh keqardhjen për manipulimin e opinionit nga individë të papërgjegjshëm dhe me qëllime të caktuara që po u bëhen vendimeve të fundit të qeverisë lidhur me masat kundër Covidit. Në këtë mes, shquhet tendenca për të manipuluar me diasporën si target grup në emër të gjoja, vendimit të 'ri' për PCR teste me rastin e ardhjes në Kosovë. Testi PCR negativ nuk është vendosur në vendimin e djeshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, por ka qenë pikë e çdo vendimi të kësaj qeverie rreth Covid-19", thuhet në sqarimin për media. Qytetarët e huaj që hyjnë në

Kosovë, përfshirë edhe ata me leje qëndrim të përkohshëm ose përhershëm në Kosovë, që vijnë nga vendet me risk të lartë sipas listës zyrtare të ECDC-së, duhet të kenë test RT-PCR negativ për Covid-19 të bërë në 72 orët e fundit, në bazë të parimit të reciprocitetit.

## Qytetarët në lokale ndëshkohen, por jo në tubime elektorale

Petrit Kllokoqi, kryetar i Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës, thotë se autoritetet kompetente po përdorin standarde të dyfishta. Ai shprehet se pronarët e lokaleve po ndëshkohen për një numër të caktuar të klientëve në lokal, kurse partitë politike po grumbullojnë qindra simpatizantë pa maska dhe pa distancë dhe në raste të rralla ndëshkohen. "Për këtë arsye,

ne kemi kërkuar falje të dënimeve. Dhe, së paku, mos të na ndalojnë pas mbarimit të zgjedhjeve, pasi e shohim se të gjithë politikanët dhe subjektet politike i kanë shkelur të gjitha rregullat", thotë Kllokoqi për Rel. Ligji për parandalimin e pandemisë, thotë ai, duket se nuk vlen për partitë politike në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare që do të mbahen më 14 shkurt. Të gjitha partitë politike në territorin e Kosovës janë duke mbajtur tubime në ambiente të mbyllura dhe të hapura, pa maska, pa distancë, pa dezinfektues, por me qindra të pranishëm. Sipas vendimit të 14 janarit 2021 të qeverisë në detyrë, në kohën e mbajtjes të këtyre tubimeve në ambiente të mbyllura lejohen vetëm 30 persona, ndërsa në hapësira publike deri në 50, gjithmonë duke respektuar masat kundër Covid-19.

## Haradinaj viziton BIK-un, shqiptarët mbeten shembulli më i mirë i bashkëjetesës

Prishtinë, 12 shkurt (ER) - Kandidati për president i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të premten Këshillin e Bashkësisë Islame në Prishtinë, me ç'rast ka takuar kryeimamin Idriz ef. Gjigoli me bashkëpunëtorë. "E nisa ditën me vizitë në Këshillin e Bashkësisë Islame

në Prishtinë, ku takova kryeimamin Idriz ef. Gjigoli me bashkëpunëtorë. Shqiptarët mbeten shembulli më i mirë i bashkëjetesës, vlerë kjo e trashëguar dhe ruajtur brez pas brezi. Përpjekjet tona për liri e pavarësi kanë njohur kontributin e prijësve fetarë

të të gjitha feve në mesin e shqiptarëve. Bashkëjetesa në mes të besimeve të ndryshme duhet të shërbejë si model edhe për skenën politike e cila ka nevojë për bashkim për t'u përballur me krizën ekonomike dhe forcimin e shtetit", ka thënë Haradinaj.



# Çmimet e konsumit shënojnë rritje për 0.5 për qind



Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar “Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit” (IHÇK) për muajin janar 2021, viti bazë 2015=100. Sipas këtij raporti, çmimet e konsumit kanë shënuar rritje për 0.5 për qind

## Rritet konsumimi i energjisë elektrike për 13.31 për qind

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar “Bilancin e Energjisë” për tremujorin e katërt (TM4) 2020. Në këtë publikim janë prezantuar të dhënat mbi prodhimin e thëngjillit, të dhënat për prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. Sipas ASK-së, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020 (TM4 2020) vlera e gjithëmbarshme e prodhimit të thëngjillit ishte rreth 2.37 milionë tonë, kurse sasia bruto e energjisë elektrike, e prodhuar në termocentrale,

ishte 1 796.3 GWh dhe në hidrocentrale ishte rreth 51.6 GWh. Sipas këtij raporti, në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM4 2019), sasia e energjisë elektrike e konsumuar është rritur për 13.31 për qind. “Sa iu përket vlerave të energjisë së importuar, respektivisht të eksportuar, gjatë tremujorit të katërt 2020 Kosova ka importuar 759.0 GWh energji elektrike, kurse ka eksportuar 597.7 GWh energji elektrike. Në TM4 2020, sasia e energjisë elektrike për konsum ishte 1 360.3 GWh energji elektrike”, është thënë në raportin e ASK-së.

10.8 për qind); qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (-4.3 për qind); blerje e automjeteve (-1.4 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (-9.9 për qind) - ‘rënie e çmimeve të naftës dhe benzinës’, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-1.9) për qind në IHÇK”, është thënë në raport.

Sipas ASK-së, ngritje e çmimeve në këtë periudhë vërehet te nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (2.6 për qind); mish (0.6 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (3.2 për qind); vajra dhe yndyra (7.3 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (2.3 për qind); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (0.7 për qind); pije alkoolike (2.2 për qind); duhan (2.8 për qind); lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (2.6 për qind); produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje (2.3 për qind); shërbime për transport (2.3 për qind) - ‘ngritje e çmimeve të biletave të transportit ajror’, shërbimet telefonike dhe të telefaksit (20.3 për qind); shërbime hoteliere (1.6 për qind); kujdes personal (1.1 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1.7-përqindësh në IHÇK.

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar “Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit” (IHÇK) për muajin janar 2021, viti bazë 2015=100. Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit, sipas ASK-së, ishte 0.5 për qind në muajin janar 2021. “Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0.5-përqindësh në muajin janar 2021, krahasuar me muajin dhjetor 2020. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (0.7 për qind); pemë (0.9 për qind); perime (6.1 për qind); pije alkoolike (1.7 për

qind); duhan (0.8 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (3.7 për qind) - ‘ngritje e çmimeve të naftës dhe benzinës’, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.8-përqindësh në IHÇK”, është thënë në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: qumësht, djathë dhe vezë (-0.5 për qind); energji elektrike (-10.5 për qind) - zbritja e çmimit të energjisë elektrike ka ardhur nga zbatimi i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, Covid-19, nr. 07/L-016, neni 15, për periudhën janar-maj 2021, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.3-përqindësh) në IHÇK. “Norma vjetore e inflacionit, e matur në muajin janar 2021 me muajin janar 2020, ishte (-0.2 për qind).

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit pësoi rënie në një mesatare prej (-0.2)-përqindësh në muajin janar 2021, krahasuar me muajin janar 2020. Kjo

kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nëngrupet e COICOP-it: pemë (-13.4 për qind); perime (-8.4 për qind); veshje (-3.4 për qind); energji elektrike (-

## Vazhdon zbatimi i programit për rimëkëmbje ekonomike

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Gjatë këtyre ditëve Qeveria e Kosovës ka përmbyllur me sukses ekzekutimin e pagesës prej 20.9 milionë eurosh për mbi 17 000 fermerë të Republikës së Kosovës. Pagesa e këtyre mjeteve nga programi për rimëkëmbje ekonomike është përmbyllur dhe plotë e programit të qeverisë për dyfishimin e mbështetjes financiare për bujqësinë, si një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së Kosovës. “Gjatë muajit janar e deri në periudhën aktuale, nga PRE 2021 janë mbështetur financiarisht të

vetëpunësuarit, bizneset e grave, fermerët, shëndetësia, policia, kategoritë në asistencë sociale dhe pensionistët. Po ashtu, janë liruar nga pagesa e semestrit veror studentët e nivelit bachelor dhe master të institucioneve të larta arsimore publike, përfshirë edhe studentët nga Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi. Janë paguar mbi 1.5 milion euro për Fondin Kosovar për Garantimin e Kredive. Rreth 45 milionë euro të paguara, mbi 280 000 përfitues.” është thënë në njoftimin e Ministrisë së Financave.






## Nënshkruhen pesë marrëveshje në mes të MEA-së dhe Komunës së Deçanit



Prishtinë, 12 shkurt (ER) - Ministri në detyrë i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Muharrem Nitaj, dhe kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, kanë nënshkruar pesë marrëveshje bashkëpunimi. Në kuadër të këtyre pesë marrëveshjeve bëhet finalizimi i projektit të kanalizimit për 18 fshatra. Nitaj me këtë rast ka deklaruar se këto pesë marrëveshje janë në kuadër të planifikimit të buxhetit për vitin 2021 dhe se ndihma që kjo ministri do t'u jepet çdo komune. "Përkushtimi i ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për t'i ndihmuar komunat, veçan kësaj komunë në buxhetin 2021 është paraparë me të vetmin qëllim që të ndihmohen këto komuna", ka thënë ai. Nitaj ka theksuar se do të vazhdojë ndihma për çdo komunë për projekte të tilla. Kurse kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, ka

falënderuar ministrin për vizitën dhe mbështetjen e vazhdueshme, sidomos për finalizimin e projektit të kanalizimit. "Deçani ka nevoja të mëdha dhe ka mbetur shumë pas, mirëpo me realizimin e këtyre marrëveshjeve ne jemi të kënaqur dhe falënderues, sepse janë disa marrëveshje shumë me rëndësi", u shpreh Ramosaj. Ministri Nitaj u shpreh se këto pesë marrëveshje mirëkuptimi do të implementohen sipas planit dinamik. Pesë marrëveshjet e nënshkruara janë: Bashkëfinancimi për ndërtimin e shtratit të lumit në Irzniq në lagjet Berisha, Mushkolaj dhe Dodaj - Deçan; ndërtimi i pendës për ujitje në fshatin Vranoc - Deçan; bashkëfinancimi për rregullimi i shtratit të Lumit Lumbardhë në Deçan; kanalizimi i ujërave të zeza për 18 fshatra të Komunës së Deçanit; dhe ndërtimi i objektit të higjienës në Deçan.

## KEDS-i mobilizon mbi 1 300 punëtorë për ditën e zgjedhjeve



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 SHKURT - KEDS-i është përgatitur maksimalisht për ditën e zgjedhjeve që të ketë furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike për të gjitha qendrat e votimit. Kjo është thënë në një komunikatë për media të dërguar nga KEDS-i. Sipas KEDS-it, mbi 1 300 punëtorë do të jenë

të angazhuar që nga momenti i hapjes së qendrave të votimit e deri në përfundim të tyre. "Ekipet do të jenë në dispozicion për të intervenuar menjëherë në rast se paraqitet nevoja në mënyrë që të sigurohet furnizim stabil me energji elektrike. Ata do të jenë të shpërndarë në secilën qendër të votimit në mënyrë që intervenimi të jetë i menjëhershëm për çdo gjë që mund të jetë e nevojshme",

është thënë në komunikatën për media, duke shtuar se, krahas kësaj, KEDS-i ka instaluar në qendrat e votimit 1 000 bateri emergjente të cilat do të vihen në përdorim në rast nevoje. "Të njëjtat, pas përfundimit të votimit, do t'u lihen në shfrytëzim shkollave. KEDS-i ka në dispozicion edhe 70 gjeneratorë mobilë të cilët do të shfrytëzohen në rast të ndonjë

të papriture në rrjet në mënyrë që mbarëvajtja e procesit të votimit të vijojë sipas planifikimeve", është thënë në komunikatë. Referuar kësaj komunikate, në ditën e zgjedhjeve furnizimi me energji elektrike do të monitorohet në kohë reale përmes programit më të avancuar "Kosovanet" dhe sistemit për kontrollimin e

nënstacioneve SCADA, i cili do të ofrojë të dhëna për secilën situatë të krijuar. Në fund KEDS-i u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që në rast të ndonjë avarie të paraqitur në rrjet, ta lajmërojnë menjëherë kompaninë duke thirrur në Qendrën e Thirrjeve pa pagesë në numrin 0800 791 00 apo duke shënuar në rrjetet sociale të KEDS-it.

## Ismajli: Pavarësisht prej rënies së rasteve aktive me Covid në Gjilan, duhet të ruhem nga virusi

Gjilan, 12 shkurt (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, nën udhëheqjen e nënkryetarit Arbër Ismajli, të premtën ka mbajtur takim për vlerësimin e situatës së pandemisë në dy ditët e fundit.

Nënkryetari Ismajli ka thënë se rënia e numrit të rasteve aktive me Covid-19 në Gjilan nuk lejon komoditet, pasi virusi ende gjendet në mesin tonë dhe ka potencial të madh infektues.

Në emër të Komitetit, Ismajli

u ka bërë thirrje qytetarëve dhe bizneseve që japin shërbime, që t'u përmbahen masave kundër përhapjes së virusit, siç janë: maska, distanca dhe higjiena personale.

Ndryshe gjendja e përgjithshme në Gjilan është si vijon: nga 10 263 mostra, 3 529 kanë rezultuar pozitivë, 3 335 janë shëruar, 108 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 86 raste janë aktive, të hospitalizuar me Covid janë dhjetë persona dhe 232 mostra në pritje për rezultat.



## Suma nderon me mirënjohje veteranët e arsimit



**HANI I ELEZIT, 12 SHKURT (ER)** - Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka pritë në takim edukatoren e arsimit parafillor në ShFMU "Ilaz Thaçi", Lebibe Koxha, arsimtarin e ShFMU "Ilaz Thaçi", Osman Kuqi, dhe

punëtorin teknik në ShFMU "Veli Ballazhi", Shaban Hasallari. Ky takim është realizuar me rastin e pensionimit të tyre dhe për t'i falënderuar për kontributin e tyre shumëvjeçar në arsimimin e shumë gjeneratave të nxënësve të

Komunës së Hanit të Elezit. Shumë vite punë në arsim për kryetarin Rufki Suma ishin arsye që këta veteranë të arsimit të Komunës së Hanit të Elezit të nderohen me mirënjohje duke i uruar për shëndet dhe jetë të gjatë.

## Rikthehen shkurtime të furnizimit me ujë në Drenas

**DRENAS, 12 SHKURT (ER)** - Kompania e Ujësjellësit ka njoftuar se si pasojë e reshjeve të shiut dhe vërshimeve në disa zona, ka rritje të sërishme të turbullirës në kanalin e Ibrit, që bën të pamundur trajtimin e ujit për pije konform standardeve dhe teknologjisë.

"Sa i përket Drenasit, është në gjendje më të rënduar për shkak që furnizimin e vetëm e ka nga stacioni i pompave në Bivolak, ku uji merret për trajtim drejtpërdrejt nga kanali i Ibrit, pa pasur alternative të tjera për furnizim", thuhet në komunikatën për media.



## Gjilan, ftohen qytetarët mbi moshën 75-vjeçare të regjistrohen për marrjen e vaksinës kundër Covidit

**GJILAN, 12 SHKURT (ER)** - Komuna e Gjilanit ka ftuar qytetarët e moshës mbi 75-vjeçare që të lajmërohen në qendrat më të afërta të mjekësisë familjare, në qytet e fshatra, për marrjen e vaksinës kundër Covidit. Drejtoresha e Qendrës së

Mjekësisë Familjare, njëherësh anëtare e Komitetit të Gjilanit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, dr. Arbenita Hajdari, ka thënë se do të fillohet me vaksinim për grup moshat që janë më të rrezikuara. "Po i

bëjmë të gjitha përgatitjet për regjistrim të vaksinimit kundër Covid-19, së pari të grupmoshës më të rrezikuar, e që janë mbi moshën 75-vjeçare e më pas vazhdojmë me kategoritë e tjera", ka thënë Hajdari.



# Jo në çdo situatë qëllimi i arsyeon mjetet, në luftë për pushtet



**Behxhet Sh. SHALA -  
BAJGORA**

**E moralshmja e pamoralshme:** Më 14 shkurt 2021 në Kosovë do të mbahen zgjedhjet për Kuvend të Kosovës me pretendime që këto zgjedhje të jenë përcaktuese edhe për zgjedhje të presidentit. Mendoj se që nga përfundimi i luftës këto zgjedhje do të vendosin për shumë gjëra dhe për kah pesha specifike politike, strategjike dhe të ardhmërisë së Kosovës, janë shumë të rëndësishme për faktin se Kosova duhet të dalë nga kjo rrugë qorre që po e mbajnë dhunshëm Serbia dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare. Jemi dëshmitarë se partitë politike në këtë parafushatë dhe fushatë zgjedhore nuk po ofrojnë ndonjë program të arsyeshëm e që, nëse jo i tëri, atëherë në masë më të madhe do të zbatohet përveç improvizimeve të çastit dhe riciklimeve të premtimeve të mëparshme. Premtimet që po japin subjektet politike ma kthejnë një kujtim dhe ngjarje nga 23 maji 1981 në Sarajevë. Ishte fundi i muajit dhe si shumica e studentëve buxhetin e kisha trokë, isha në mbikëqyrje 24-orësh të sigurimit shtetëror jugosllav sepse kisha informatë të saktë sikur që vëreja një prani më të madhe të fytyrave që vëzhgonin banesën ku banoja sikur edhe, po të njëjtat fytyra vinin në Fakultetin e Mjekësisë, më me rregull se unë. Që nga e hëna vërehej se ishin sigurimca apo hetues policorë. Në ato rrethana, ndonëse isha i sigurt 100 për qind se do të më arrestonin, bëja përpjekje ta organizoj jetën dhe ta ruaj një normalitet. Shumë studentë shqiptarë në Sarajevë ishin nën vëzhgim të policisë, prandaj ishin këputur lidhjet e komunikimit. Në atë ditë, më 23 maj 1981, isha duke shkuar në Bashqarshi dhe në qendër të qytetit, përballë ndërtesës ku ishte vendosur Oslobogjenje (gazetë ditore kryesore në B dhe H në atë kohë), më ndali një grua rome, me një kuti druri në të cilën ishte vendosur një miush i bardhë dhe disa pliko prej letre ngjyrë deti. Tërë

kohën kjo fallxhorja thërriste: "Mish bijelli, sreqi dijelli - miu i bardhë, ndan fat". Natyrisht, nëse paguani një sasi parash, miu e merr një pliko për ju, e gris me dhëmbë e pastaj parashikuesja jua lexon fatin. Paraprakisht e merr miun dhe e sjell tri herë para fytyrës suaj e pastaj, duke ia shtrënguar qafën, e shëtit në kutinë me pliko. Kur ia afronte kokën te plikojat që donte, fallxhorja ia lironte qafën, miu e bënte punën dhe vazhdonte procedura. Fallxhorja thoshte se miu e tërheq plikon e duhur në bazë të erës së klientit, për të qenë më bindëse. Paraprakisht, fallxhorja më pyet për profesion, nga vij, a jam i martuar, gjendja materiale etj. Me të mësuar se jam student, se jam shqiptar dhe se jam i pamartuar, filloi "ligjërimin" që shkonte me profilin tim. Më tha se nuk ke para, se brenda një jave do të marrësh para (e merrja bursën sikur edhe paratë nga familja në çdo fillim të muajit), se jam trim dhe besnik (shqiptar), se do të shkoj në pushim, ku do të kaloj shumë mirë, se do të bëhem ndërtues i madh (i thashë se e studioj arkitekturën), ndërsa në planin e dashurisë më tha se pas meje çmendet një brune, më sheh ëndërr një zeshkane sikur që është shumë xhelozë një biondinë. Realisht, prej asaj që më tha fallxhorja u konkretizuan këto parashikime: shkova në pushim aspak të mirë në afatin trevjeçar në Burgun e Foçës dhe të Mostarit me vendim të Gjykatës së Qarkut në Sarajevë, si nacionalist dhe irredentist shqiptar, më erdhi bursa dhe paratë nga familja, por se nuk mund t'i shfrytëzoja nga Qendra e Paraburgimit në Sarajevë, të dashurat që mendonin për mua ku përfshihen të gjitha ngjyrat e flokëve munguan derisa e përfundova burgun e parë. Në vend të tyre shihja policë dhe të burgosur, me flokë dhe pa flokë si dhe femra të vizatuara nga të burgosurit në muret e tualeteve të burgut. Paratë që ia dhashë fallxhores ma anuluan biletën për shfaqje të filmave paradite, matine, bardh e zi në një kinema në Sarajevë ku planifikoja ta shihja filmin Psiho të Alfred Hiçkokut. Pas dy dite, përkatësisht më 25 maj, më arrestuan dhe më dërguan në ndërtesën e gazetës Oslobogjenje, ku i kishte zyrat sigurimi shtetëror i Bosnjë dhe Hercegovinës. Për ta

përbushur parashikimin e fallxhores, inspektorë të sigurimit shtetëror, pas seancave të gjata të marrjes në pyetje, e thirrën qendrën e paraburgimit në Sarajevë për të më rezervuar një vend për pushime me fjalët: "Mollim vas, pripremite jedan apartman za gospodina Shalu. - Ju lutem, e bëni një apartament gati për zotëri Shalën". Fjalor tipik për një agjenci turistike. Merreni me mend, nuk e rezervuan për mua një dhomë, por një apartament apo suitë! Pas 40 minutave apartamenti u zëvendësua me një birucë, sikur në romanet e Manxonit. A nuk po ju ngjanë, së paku pakëz fallxhorja e Sarajevës e vitit 1981 me premtimet e partive politike të vitit 2021? Fallxhorja e kishte të qartë se studentëve iu duhen paratë, prandaj ofronte para; se kishin nevojë për pushim, prandaj ofronte pushim; se si të rinj kishim nevojë për dashuri, prandaj na ofronte tërë spektrin e botës femërore; se jam trim (ndonëse edhe nuk isha aq i madh) duke prekur krenarinë e shqiptarëve; se do të jem ndërtues i madh (bëri gabim sepse ia dhashë

informatën e gabuar). Po e shihni se më ofroi të gjitha ato që i do një njeri dhe që i bëjnë mirë dhe që ndihet i lumtur. Jam i sigurt se të gjitha plikotë kanë pasur të njëjtën përmbajtje! Edhe partitë politike ofrojnë rritje të pagave, vende të reja pune, liberalizim të vizave, jetë më të mirë, shërbime më të mira! Kush do t'i kundërshtonte këto oferta të partive politike?! Po flasin për referendum që do ta përligjte 100 për qind pushtetin duke përfshirë, mundësisht 100 për qind kundërshtarët politikë që i konsiderojnë si armiq. Po flasin për investime miliarda e miliarda euro në ndërkohë që buxhetin e kemi si thes i shqyer. Po flasin për njohje nga Serbia në kohën kur Serbia qe 21 vjet pasi ka përfunduar lufta, jo që nuk na njeh, por nuk na lejon as t'i hapim sytë. Uroj që qytetarët e Kosovës ta kenë fatin më të mirë se që e pata unë në Sarajevë.

**Parashikimi i rezultateve:** Nuk jam as studiues, as analist, as intelektual, as i mençur, madje në shumë shkrime kam deklaruar se nuk marrë përgjegjësi për atë që e shkruaj

dhe e parashikoj, nuk më ka paguar asnjë studio televizive, asnjë portal dhe asnjë parti politike e as politikan, nuk kam bërë sondazhe por, si i papërgjegjshëm që jam, e marr guximin t'i parashikoj rezultatet sipas kriterëve që vetë i përcaktoj. Një ditë një mik imi më tha: "Valla Behxhet, trim je..." e që unë e mora se më tha. "Valla Behxhet, po budalla i madhe je..." duke iu referuar thënies popullore: "Trim budall...". Kështu:



Vetëvendosje - 39 për qind të votave  
Partia Demokratike e Kosovës - 23 për qind të votave  
Lidhja Demokratike e Kosovës - 23 për qind të votave  
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - 9 për qind  
Nisma - 4-5 për qind të votave  
Marzha e gabimeve, 2-3 për qind që lejohet thua ja në të gjitha sondazhet. Pasi unë nuk kam bërë sondazh, marzha e gabimit tek unë është, sa të dua unë. Vetë pret, vetë mbret!  
Uroj zgjedhje të mira, të rregullta dhe të drejta. Krejt dhe Drejt në Shtetin. Shtet të Rimëkëmbjes, Me Forcën e Kosovës dhe Me Çlirimtarët.



## Funksionalizohet laborator viro-bakteriologjik në QKMF

Podujevë, 12 shkurt (ER) - Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë është bërë funksionalizimi i laboratorit viro-bakteriologjik për zbulimin e bacilit të tuberkulozit për gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës. Nën kryetarja e Komunës së Podujevës, Marigona Lahu, së bashku me stafin udhëheqës të QKMF-së ka bërë përrurimin e këtij laboratorit

viro-bakteriologjik, përmes të cilit qytetarët do të kenë mundësinë këtë shërbim të analizave ta marrin në QKMF. Nën kryetarja Lahu ka pohuar se një nga prioritetet e punës së ekzekutivit të komunës mbetet krijimi i kushteve më të mira për personelin shëndetësor dhe për shërbime cilësore për qytetarët e Podujevës.



# FUSHATA ZGJEDHORE NË KOSOVË DHE FUSHATA KUNDËR ALI AHMETIT E ALBIN KURTIT




Ismet SYLEJMANI

Sa më shumë që po afrohet 14 shkurti dita kur do të mbahen votimet në Kosovë, edhe më shumë po intensifikohen publikimet e shkrimeve të rrejshme në portale inekzistente e anonime, shkrime të cilat kanë për personazhe të tyre themeluesin e UÇK-ve, ish-Komandantin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Udhëheqësin e popullit shqiptar e Liderin e BDI-së Ali Ahmetin dhe Liderin e Vetvendosjes e ish-Kryeministrin e Kosovës Albin Kurtin!

Këto shkrime shihet qartë se e kanë të njëjtin burim dhe në të njëjtën kuzhinë përgaditen e shpërndahen për ushqim helmues kundër popullit shqiptar!

Armiqtë e vjetër dhe armiqtë e rinj të Ali Ahmetit dhe të Albin Kurtit, kundërshtarë këta të mëdhenjë të BDI-së e të VV-së, bëjnë orvatjet e pandërprera që ti armiqësojnë këto dy figura të mëdha e të shquara të popullit shqiptar dhe partite e tyre ti bëjnë rivale në vend se të ishin motra, sikurse këto dy figura që janë vëllezër të një gjaku, të një ideali e të një kauze të përbashkët, atë të prosperimit dhe të progresit euroatlantik të kombit shqiptar!

Shkrimet se Ali Ahmeti ka deklaruar se Albin Kurti është kështu, apo ashtu, etj., etj., janë shpifje të kulluara, janë





qëllimkqija dhe tendencize! Ali Ahmeti i ka demantuar publikisht këto shpifje të ulta e të dëmshme, që kanë për qëllim cenimin dhe përkeqësimin e mardhënieve normale, korrekte e vëllazërore të udhëheqësve e drejtuesve politik shtetërorë të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut!

Fushata jo vetëm në kohë zgjedhjesh, se Ali Ahmeti është duke etiketuar Albin Kurtin për

produkt serb dhe se ardhja e tij në pushtet e rikthen Serbinë në Kosovë, janë broqkulla të gatuara në kuzhinat e Beogradit e Moskës, dhe të shpërndara nga distributorët e shkollës së vjetër antishqiptare maqedone të Mojsovit e Kolishevskit, këto orvatje do të dështojnë me turp, sepse kanë përenduar kohërat e errëta për popullin shqiptar!

Prishtinë, 12 shkurt 2021





QENDRA SPORTIVE  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Kastrati: Na duhen fitoret për kualifikim

Ashtu sikurse kapiteni Dardan Berisha, edhe basketbollisti Erjon Kastrati beson se Kosova mund të kualifikohet tutje. "Të gjithë e dimë se si është situata. Në nëntor kemi humbur dy ndeshjet dhe në shkurt duhet t'i fitojmë ndeshjet dhe të kualifikohemi më tutje. Të gjithë e dimë rëndësinë e ndeshjeve dhe do ta japim maksimumin për t'u kualifikuar tutje. Shikuesit do të na mungojnë shumë, sepse janë lojtari i gjashtë, por e kemi përparësinë që luajmë në Prishtinë, edhe pse pa tifozë. Besoj se do të kalojmë mirë", ka thënë Kastrati



FBK-së, "Kujtesës" dhe në "Televizionin T7". Për shkak të masave kundër Covidit, takimet do të zhvillohen pa praninë e medie, pasi që FIBA ka kërkuar që të respektohen të gjitha rregullat në përpikëri dhe nuk do të ketë asnjë lëshim. "Tifozët e Kosovës, 'dardanët', gjithmonë kanë përkrahur basketbollistët e Kosovës, megjithatë kjo nuk do të jetë e mundur kësaj radhe përkundër përpjekjeve të FBK-së. Basketbollistët e Kosovës janë duke u përgatitur nga dita e martë për këto dy ndeshje shumë të rëndësishme. Nëse 'dardanët' shënojnë dy fitore në dy takimet e zhvilluara, atëherë do të kualifikohen në rrethin e ardhshëm", thuhet në njoftimin e FBK-së.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 12 SHKURT** - Basketbollistët e Përfaqësueses së Kosovës në basketboll janë duke u përgatitur për dy ndeshjet e rëndësishme ndaj Luksemburgut (18 shkurt) dhe Sllovakisë (20 shkurt). Basketbollisti Erjon Kastrati të premten ka thënë se "dardanët" janë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtyre dy ndeshjeve, prandaj janë të motivuar që të dalin me rezultat pozitiv. Sipas tij, mungesa e madhe për këto dy

ndeshje do të jetë mosprania e shikuesve për shkak të pandemisë Covid-19, por ai beson se "dardanët" do të dalin të suksesshëm. "Të gjithë e dimë se si është situata. Në nëntor kemi humbur dy ndeshjet dhe në shkurt duhet t'i fitojmë ndeshjet dhe të kualifikohemi më tutje. Të gjithë e dimë rëndësinë e ndeshjeve. Do ta japim maksimumin për t'u kualifikuar më tutje. Shikuesit do të na mungojnë shumë, sepse janë lojtari i gjashtë, por e kemi përparësinë që luajmë në Prishtinë, edhe pse pa

tifozë. Besoj se do të kalojmë mirë", ka thënë Kastrati. Kosovës i duhen dy fitore që të kualifikohet në rrethin e ardhshëm, kurse bordi i FIBA Evropës ka vendosur që të gjitha ndeshjet e Dritares së Tretë të Grupit B të zhvillohen në Prishtinë. Për dy ndeshjet e këtij muaji të enjten ka folur edhe kapiteni Dardan Berisha, i cili beson se Kosova mund të kualifikohet tutje. "Unë kam munguar në ndeshjet e nëntorit, por prapë kemi disa mungesa. Entuziazmi është i madh, pasi po luajmë në vendin tonë. Shpresoj të

përgatitemi sa më mirë. Kemi cilësi dhe nëse nuk kemi lëndime, kemi gjasa për t'u kualifikuar tutje", ka deklaruar Berisha.

### Ndeshjet e Kosovës zhvillohen pa shikues

Përfaqësuesja e Kosovës do t'i zhvillojë dy ndeshje të rëndësishme në kuadër të parakualifimeve evropiane për Kupën e Botës 2023 pa praninë e shikuesve, por këto dy ndeshje do të transmetohen nëpërmjet partnerit medial të

### ORARI

Më 18 shkurt takohen:  
16:00 Sllovakia-Islanda  
19:00 Kosova-Luksemburgu

Më 20 shkurt takohen:  
16:00 Luksemburgu-Islanda  
19:00 Kosova-Slovakia

## Rikthehen 'ethet' Superligë!

Pas një pauze të gjatë, Superliga e Kosovës në futboll rikthehet me ndeshjet e javës së 19

**PRISHTINË, 12 SHKURT (ER)** - Kampionia në fuqi, njëherësh kampione vjeshtore, Drita, do ta nisë sezonin pranveror me ndeshje derbi, pasi në Gjilan e pret skuadrën e Llapi. Drita në dy ndeshjet e fundit pësoi humbje nga Prishtina në kuadër të finales së Superkupës dhe 1/8 së finales së Kupës, kurse Llapi është kualifikuar në çerekfinalen e Kupës pas fitores ndaj Ballkanit. Në kampionat gjërat janë ndryshe dhe kampionët llogariten favoritë. Sot (e shtunë) zhvillohet edhe

ndeshja në mes të Prishtinës dhe Drenicës. Kryeqytetasit po kalojnë nëpër një formë të mirë dhe luajnë në stadiumin "Fadil Vokrri", prandaj presin maksimumin e pikëve ndaj kuqezinjve nga Skenderaj, të cilët kanë bërë shumë ndryshime në afatin kalimtar të janarit. Skuadra e fundit në tabelë, Besa, e pret Ballkanin. Të dielën nuk do të ketë ndeshje për shkak të zgjedhjeve, kurse të hënën zhvillohen dy ndeshjet e tjera, ku takohen Feronikeli - Gjilani dhe Trepça '89 - Arbëria.



SUPERLIGA - Javë 19

Të shtunën takohen:  
13:00 Drita - Llapi  
13:00 Prishtina - Drenica  
13:00 Besa - Ballkani

Të hënën takohen:  
13:00 Feronikeli - Gjilani  
13:00 Trepça '89 - Arbëria

## Infantino vazhdon mbështetjen për FFK-në

**DOHA, 12 SHKURT** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, gjatë qëndrimit në Doha ka zhvilluar takim me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino. Gjatë bashkëbisedimit numri një i FIFA-s tregoi afërsinë me

presidentin Ademi dhe përkushtimin e tij për FFK-në, duke u interesuar deri në hollësi për aktivitetin e FFK-së, veçmas në këtë periudhë të vështirë të pandemisë. Sipas njoftimit të Infantinos, edhe një herë shprehu respektin maksimal për komunitetin e

futbollit në Kosovë dhe ofroi mbështetje për FFK-në. Të dy presidentët shprehën shpresën që së shpejti do të tejkalohet sfida globale me pandeminë Covid-19 dhe të gjithë do t'i rikthehemi normalitetit dhe spektaklit në stadiumet e futbollit.



## Mezani: Futboli në Shqipëri, shumë herë më lart se në Kosovë

**TRANË, 12 SHKURT** - Trajneri shqiptar Gentjan Mezani është pa punë që nga largimi i tij nga stoli i SC Gjilanit. Mezani ka thënë se aktualisht nuk është momenti që të marrë ndonjë skuadër, ndonëse ka pranuar

se pret oferta. Ish-trajneri i Laçit foli edhe për dallimin në mes të kampionatit shqiptar dhe atij të Kosovës. “E ardhmja? Kurrë nuk thuhet kurrë. Pres oferta dhe do ta analizoj atë që do të vijë. Nuk është

momenti i mirë për të marrë skuadër sepse duhet t'i marrësh përgjegjësitë”, ka thënë Mezani. “Kampionati shqiptar është shumë herë më lart, por Kosova është rritur shumë në kohët e fundit duke marrë lojtarë me

cilësi. Problemi tek ata janë stadiumet, që nuk janë si në Shqipëri. Kampionati shqiptar prej kohësh është pa dyshim më lart se i Kosovës”, ka deklaruar Mezani në emisionin “Pressing”.



## Organizatorët e ‘Tokio 2020’: Nuk kemi mjekë dhe infermierë për olimpiadën

**TOKIO, 12 SHKURT** - Organizatorët e Lojërave Olimpikë “Tokio 2020” kanë lëshuar të premtën alarmin se nuk kanë në dispozicion staf mjekësor të mjaftueshëm për të përballuar këtë ngjarje. Si pasojë e pandemisë Covid-19, të gjithë mjekët e infermierët japonezë janë të impenjuar me punën e përditshme dhe nuk kanë kohë për ta kryer vullnetarin gjatë olimpiadës siç dhe ishte parashikuar. “Është e pamundur që t’ua kërkojmë këtë gjë, që ta kryejnë vullnetarin me kohë të plotë. Mjekët e infermierët kishin pranuar të kryenin këtë rol, por situata ndryshoi për shkak të pandemisë. Tani ata janë të mbingarkuar me punën e tyre të përditshme në spitale. Ndaj, nuk mund t’u



kërkojmë të bëjnë me çdo kusht vullnetarin në olimpiadë”, ka thënë drejtori i Tokyo Medical Association. Ai ka shtuar se për këtë olimpiadë, për një periudhë dymujore (15 korrik-

15 shtator, ku përfundon edhe olimpiada për personat me aftësi të kufizuara), nevojiten të paktën 3500 personelë mjekësorë shtesë, mjekë e infermierë.

## Curry shkëlqen në fitoren e Golden States, zhgënjën Philadelphia



**SAN FRANCISCO, 12 SHKURT** - Një Stephen Curry në formë të shkëlqyer, duke realizuar 40 pikë, i dha fitoren skuadrës së Golden States, 111-105, ndaj Orlandos. Sukses i vështirë për Warriorsin, ndërkohë që mirë u paraqit edhe Wiggins me 21 pikë. Surprizë humbja e ekipit të Philadelphia, kryesuesit të renditjes në Lindje, që u mund 118-114

nga Portlandi. Embiid bëri detyrën, duke realizuar 35 pikë, por që s’mjaftuan. Për Portlandin u dallua Lillard me 30 pikë. Në ndeshjet e tjera të luajtura, Miami e mposhti me rezultat 101-94 Houstonin, takim ku diferencën e bëri Butleri me një “triple double” (27 pikë, 10 rebounde e 10 asistime). Ndërsa Bostoni e mposhti me rezultat 120-106

Toronton (Ojeleye, 24 pikë), ndërsa Indiana fitoi ndaj Detroitit me rezultat 111-95 (Sabonis, 26 pikë).

### REZULTATET

Boston - Toronto	120-106
Houston - Miami	94-101
Detroit - Indiana	95-111
Golden State - Orlando	111-105
Portland - Philadelphia	118-114

### SHKURT

#### Bare, lojtari i muajit te Espanyoli

Futbollisti shqiptar Kleidi Bare është zgjedhur lojtari më i mirë i Espanyolit për muajin janar. Pas votave të tifozëve, çmimi i lojtarit të muajit i ka takuar mesfushorin shqiptar. Bare ka regjistruar pesë ndeshje për Espanyolin që këtë edicion bën gara në kategorinë e dytë të futbollit spanjoll. Kleidi është transferuar te klubi katalunas në shtator të vitit 2020 nga Malaga.

#### Milani ‘blindon’ Kessien

Milani po punon fuqishëm për t’i rinovuar kontratat me futbollistët. Një ndër lojtarët të cilët kuqezinjët kërkojnë të “blindojnë” është Franck Kessie të cilit kuqezinjët i kanë ofruar rinovimin deri në vitin 2026. Mesfushori ka dhënë “ok” për qëndrimin e tij, por mbetet për t’u gjetur gjuha e përbashkët rreth çështjes financiare. Drejtuesit nga Milanello i kanë propozuar lojtarit një pagë prej 3 milionë eurosh në sezon, çka e kënaq pjesërisht futbollistin, i cili është në pritje të një oferte të dytë nga drejtuesit për sa i takon pagës.

#### Flick: Sezoni më i bukur në historinë e Bayernit


Bayern Munchen festoi fitimin e një tjetër trofeu ditën e djeshme, i gjashti me Hansi Flick si trajner. Gjermani mori drejtimin e ekipit “bavarez” nëntorin e vitit 2019 dhe po bën një punë të shkëlqyer në stol. Djemtë e tij mposhtën 1-0 meksikanët e Tigres falë golit të Pavardit dhe fituan Botërorin për Klube. Gjashtë trofe si trajner i Bayern Munchenit dhe vetëm pesë humbje, një statistikë e jashtëzakonshme për Flick. “Urime skuadrës për këtë arritje historike, fitimin e trofeut të gjashtë brenda një viti. Ka qenë sezoni më i bukur dhe fitues i historisë së Bayern Munchenit. Kemi pasur disa probleme në ditët e fundit, por djemtë luajtën në mënyrë të jashtëzakonshme. Të gjithë jemi krenarë për atë që kemi bërë. Është e pabesueshme ajo që kemi arritur”, ka deklaruar Flick.

#### City e sheh Lukakun si zëvendësues të Agueros

Largimi i Sergio Agueros në fund të sezonit ka detyruar drejtuesit e Manchester Cityt ta nisin punën për të gjetur një zëvendësues të argjentinasi. Trajneri Pep Guardiola është i fiksuar pas idesë për të sjellë në një sulmues kalibri dhe në listën e dëshirave është Romelu Lukaku. Këta zëra janë konfirmuar edhe në Itali ku, sipas “FcInterNews”, Guardiola u ka sugjeruar drejtuesve të klubit emrin e sulmuesit belg. Vështirë të mendosh që Lukaku të largohet nga Interi, skuadër ku po kalon periudhën më të mirë në karrierë.

#### Mourinho rezikon shkarkimin

Trajneri Jose Mourinho nuk e ka të sigurt mbajtjen e postit të trajnerit të Tottenham Hotspur. “Daily Mirror” ka raportuar të premtën se drejtuesit e “Spurs”-ve nuk janë të kënaqur me rezultatet e fundit të ekipit dhe po mendojnë për shkarkimin e portugezit. Tottenhami në pesë ndeshjet e fundit në të gjitha garat ka regjistruar katër humbje dhe kjo seri negative mund t’i kushtojë shtrenjtë trajnerit 58-vjeçar, i cili në nëntor të vitit 2019 mori drejtimin e kësaj skuadre dhe ka kontratë deri në muajin qershor të vitit 2023.



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

**KONKURS**

Zyrtar/e për Marrëdhënie me Publikun pranë OMK-së – Gazetar/e në Revistën e OMK-së

Numri i pozitave: 1 (një) vend pune

Nr. ref: 02/2021

Kohëzgjatja e Kontratës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Orari i punës: Orari jo i plotë (20 orë në javë)

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Përgatit hulumtime, reportazhe, intervista dhe materiale tjera mediale;
- Merr pjesë në të gjitha takimet e redaksisë së revistës së OMK-së;
- Siguron informata dhe të dhëna nga terreni për nevoja të artikujve dhe shkrimeve që i përgatitë;
- Realizon intervista, vizita studimore në organizata dhe/ose institucione relevante për fushat tematike;
- Organizon dhe mbikëqyrë aktivitete promovuese;
- Mbështet mirëmbajtjen dhe rifreskon përmbajtjen e ueb faqës dhe medieve sociale;
- Ndihmon në hartimin dhe përgatitjen e raporteve, korrespondencave, promovimit dhe marrëdhëniet me publikun;
- Ndihmon dhe përkrah të gjithë të interesuarit dhe bashkëpunëtorët në aspektin administrativ: shënimeve, raporteve, punëve rreth marketingut, komunikatave, shkresave;
- Ndihmon në hulumtime kuantitative dhe kualitative dhe i mbledhë/analizon informata duke përdorë metoda dhe teknika të ndryshme punëve administrativo-juridike dhe marrëdhëniet me publikun;
- Ndihmon në kryerjen detyrave tjera të përcaktuara nga mbikëqyrësi brenda fushës së përgjegjësisë.

**Shkollimi i kërkuar:** Kandidati/ja duhet të jetë i/e diplomuar në Arsimin Universitar në fushën e gazetarisë;

**Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- 3 (tri) vite përvoj pune
- Shkathësi të mira në të shkruar të artikujve dhe teksteve;
- Të ketë njohuri të mirë të gjuhës Angleze (në shkrim dhe në folur);
- Të ketë përkushtim dhe interesim për të mësuar;
- Shkathësi të mira të komunikimit;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter (Word, Excel dhe Internet Explorer);
- Të jetë dinamik, fleksibil, kreativ dhe i/e gatshëm për punë në ekip;
- Aftësi negociuese;
- Njohuri nga fusha e shëndetësisë është përparësi; dhe
- Çdo kualifikim tjetër do të konsiderohet si përparësi.

**Paraqitja e kërkesave:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, [www.omk-rks.org](http://www.omk-rks.org) dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org) apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të emailit të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

**Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.**

Verëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **12.02.2021** deri më **01.03.2021, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300** apo **038 / 544-872.**

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



**Kompania Rajonale e Ujësllësit**  
Regional Water Supply Company  
Regionalna vodovodna kompanija

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT KRU 'GJAKOVA' Sh.A. –GJAKOVË**

Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe autorizimeve të dhëna nga Bordi i Drejtoreve me rregulloren për marrjen dhe dhënien me qira të objekteve të KRU'Gjakova'SH.A-Gjakove Shfrytëzimi i hapësirave do të bëhet me qëllim të trajtimit të drejtë, si dhe sigurimit të mundësive më të mira, për të krijuar te hyra,bazuar në rregulloret e brendshme dhe Ligjet në fuqi nxjerr këtë:

**Ftesë për ofertim për marrjen me qera të hapësirave për Pika Arkëtuese për KRU"GJAKOVA "sh.a-Gjakovë.**

**Kushtet e KRU'Gjakova" sh.a për marrjen e hapësirave me qera per pikat arketuese Gjakove, Prizren.**

- Dokumentacioni pronësoro-juridik urbanistik në rregull,
- Nyje sanitare (banje, tualet),
- Dysheme me pllaka, parket, ose laminat
- Vendosje të grilave- parrakeve të sigurisë sipas kërkesës së komisionit
- Ndriqim të mjaftueshem në përputhje me hapësirën e zyrës postare,
- Pa obligime paraprake financiare ndaj Ujesllësit, KEDS dhe shërbimeve tjera komunale,
- Njehsor te veqante te energjise elektrike dhe te ujit (ujëmates),
- Hapësire e mjaftueshme në m2 për ushtrimin e veprimtarisë për pika të shitjes,
- Kati përdhes i objektit,

Afati kohor i marrjes me qera në kohëzgjatje prej 1 vit me mundësi vazhdimi

**KRITERET E KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë**

Të drejtë pjesëmarrje kanë si personat fizik dhe juridik.

Persona fizik duhet të kenë kopjen e letërnjoftimit , vërtetimin nga Gjykata që nuk janë në hetime

Personat juridik duhet të sjellin certifikatën e regjistrimit të biznesit kurse vërtetimi nga Gjykata në emër të Operatorit ekonomik se nuk është në hetime

**INFORMATA ADMINISTRATIVE**

- Komision i themeluar nga KRU'Gjakova' sh.a., do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertës më të mirë dhe më të favorshme.
- Obligimet tatimore zbriten sipas Ligjeve në fuqi,
- Ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura.
- Afati për dorëzimin e ofertave: është deri me datën 26.02.2021 në ora 16:00.
- Vendi i dorëzimit, arkiva e KRU"Gjakova sh.a. Gjakova rr. UÇK nr 7 50000 Gjakove.nr tel 0390320503



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

PRISHTINË



Hekurudhat e Kosovës

Kryeshefi Ekzekutiv në bazë të nenit 17 paragrafi 3, pika 1 e Statutit të HK-Trainkos-SH.A nr. 1/188, të datës 05.10.2015, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe në bazë të nenit 4 të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MPMS) NR. 07/2017, shpall:

## KONKURS PËR PERIUDHË TË CAKTUAR

**Titulli i pozitës së punës:** Makinist

**Institucioni:** Hekurudhat e Kosovës-Trainkos- SH.A.

**Tipi i Akt Emërimit të punës:** I plotë/ sipas ndërrimit

**Titulli i mbikëqyrësit:** Shef i Tërheqjes së Trenave në Transport të Mallrave

**Kohëzgjatja e kontratës:** Me periudhë të caktuar (120 ditë nga nënshkrimi i Kontratës së Punës)

**Procedura e aplikimit:** I jashtëm

**Vende të lira punë:** 3 pozita (vende pune)

**Vendi:** Fushë Kosovë

### Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon dhe verifikon gjendjen teknike të lokomotivës para nisjes për trenin e planifikuar;
- Kontrollon dhe vërteton lokomotivën se a është e furnizuar me naftë, vaj, ujë, rërë dhe inventar;
- Bën manovra të nevojshme në oborr të deposë;
- Është përgjegjës për manipulimin me lokomotivë prej pranimit deri në dorëzim të saj;
- Përcjell dhe zbaton rregullat e sigurisë në trafik dhe udhëzimet tjera që janë të aplikueshme;
- Udhëheqë formularët e nevojshëm (Et-1 dhe fletudhëtimin);
- Kryen urdhëresat e drejtuesve të trenave sipas urdhërave të shkruar;
- Siguron lokomotivat gjatë sezonit dimëror nga ngricat;
- Kryen provën e frenimit nëpër stacione të trenat pa personel shoqëruar;
- Përcjell dhe respekton shenjat sinjalizuese stabile dhe të personelit nëpër stacione;
- Kryen urdhëresat e mbikëqyrësit të lokomotivës dhe dispeçerit;
- Raporton për gjendjen teknike të lokomotivës gjatë dorëzimit;(me librin Et-63)
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Shefit të Njësisë në koordinim me Menaxherin e Sektorit;
- I përgjigjet Shefit të Njësisë.

### Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Teknik i komunikacionit hekurudhor – Makinist;
- Të jetë i licencuar si makinist nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) të Kosovës;
- Dëshmi për përvojën e Punës minimum një (1) vit;
- Aftësi të mira komunikuese dhe organizative;
- Të jetë konfidencial dhe i angazhuar në kryerjen e detyrave;
- Aftësi për të punuar nën presion dhe në grup;
- CV;
- Preferohen njohjet kompjuterike të programeve (Word, Excel, Internet, Outlook, etj.);
- Njohja e gjuhëve zyrtare, preferohet njohja e gjuhës angleze, serbe;
- Të ketë grupën e parë të kontrollës sistematike (të ketë dëshmi).

**Titulli i pozitës së punës:** Udhëheqës Treni – Ndihmës Makinist

**Institucioni:** Hekurudhat e Kosovës -Trainkos-SH.A.

**Tipi i Akt Emërimit të punës:** I plotë/sipas ndërrimit

**Titulli i mbikëqyrësit:** Shef i Tërheqjes së Trenave në Transport të Mallrave

**Kohëzgjatja e kontratës:** Me periudhë të caktuar (120 ditë nga nënshkrimi i Kontratës së Punës)

**Procedura e aplikimit:** I Jashtëm

**Vende të lira punë:** 2 pozitë (vend pune)

**Vendi:** Fushë Kosovë

### Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen regjistrimin e trenave;
- Kryen pranimin, kontrollon përgatitjen e trenave, rregullimin e ngarkimit në vagonë, gjendjen e vagonëve dhe blombave;
- Barazon dokumentet me vagon (fletëngarkesat);
- Llogaritë peshën e trenit, peshën frenuese dhe përgatitë raportin e përgatitjes dhe frenimit të trenit;
- Udhëheqë fletë udhëtimin me formular tjerë ndihmës tek treni;
- Udhëheqë punët manovruese nëpër stacione;
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve, vendosjen (tërheqjen) me kohë të vagonëve në binar të shkarkimit ose binar industrial sipas orarit të manovrave;
- Bën pranim dorëzimit të vagonëve përmes (Vag-4) në binarët Industrial;
- Përgjigjet për siguri në komunikacion;
- Verifikon gjendjen teknike të lokomotivës para nisjes për trenin e planifikuar;
- Kontrollon dhe verifikon lokomotivën se a është e furnizuar me naftë, vaj, rërë dhe ujë në sistemin e ftohjes dhe e njofton makinistin;

- Pranon aparatet kundër zjarrit dhe inventarit tjetër që gjendet në kabinë të lokomotivës si dhe pajisjet tjera sinjalizuese dhe të njëjtat i dorëzon;
- I përcjell makinistit shenjat sinjalizuese nga ana e majtë në trafik dhe jep udhëzime tjera për sigurinë në trafik;
- Kryen provën e frenimit nëpër stacione tek trenat manipulues;
- Bën manovra në depo sipas kërkesës së makinistit gjegjësisht mbikëqyrësit të lokomotivave;
- Bën pastrimin e kabinës së lokomotivës bashkë me makinistin;
- Kryen edhe punët tjera sipas urdhërave të shefit të shërbimit, dokumentit teknik të stacionit pjesa e II-të sipas urdhërave të drejtuesve të trenave, urdhërave nga Dispeçeri dhe Shefi i stacionit;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Shefit të Njësisë në koordinim me Menaxherin e Sektorit;
- I përgjigjet Shefit të Njësisë.

### Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Shkolla e mesme profesionale, preferohet drejtimi hekurudhor;
- Dëshmi për përvojën e Punës minimum një (1) vit;
- Aftësi të mira komunikuese dhe organizative;
- Të jetë konfidencial dhe i angazhuar në kryerjen e detyrave;
- Aftësi për të punuar nën presion dhe në grup;
- CV;
- Preferohet shkathtësia kompjuterike të programeve (Word, Excel, Internet, Outlook, etj.);
- Njohja e gjuhëve zyrtare, preferohet njohja e gjuhës angleze, serbe;
- Të ketë grupën e parë të kontrollës sistematike (të ketë dëshmi).

Aplikacioni dhe konkursi mund të merret në ndërtesën e Drejtorisë në Fushë Kosovë apo në [www.trainkos.com](http://www.trainkos.com). Aplikacioni së bashku me dëshmitë të dorëzohen në ndërtesën e Drejtorisë së HK-Trainkos-SH.A. në adresën "Sheshi i Lirisë" nr. 22, në Fushë Kosovë.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur, në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: **01.03.2021 ora 16:00**. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk iu kthehen. Vetëm kandidatet e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Alban Susuri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Naim Frashëri " Vlashnje.

► Muharem Duraku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Bajram Curri " Krushe e Madhe.

► Etnik Omaj shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 09.02.2021, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësim të vendit të punës në kohë të pacaktuar, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 12.02.2021 të shpallë;

**KONKURS**

Për plotësimin e vendit të punës:

**Zyrtar i Arkivës - me kohë të pacaktuar**, Njësia Punuese Vushtrri

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Bënë klasifikimin, arkivimin dhe ruajtjen e lëndëve dhe dokumenteve;
- Mban librin e arkivit si dhe pasqyrën e materialit të tërësishëm arkivor;
- Kryen të gjitha punët për ç' regjistrimin e lëndëve të cilave u ka kaluar afati;
- Pranon, shpërndanë dhe përgaditë tërë postën për Njësia;
- Mban protokolimin dhe vulat e Njësia;
- Si dhe punë tjera të kësaj natyre, të cilat i përcaktonë eprori i drejtpërdrejtë.
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njësia.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 3 muaj);
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori një (1) vit do të jetë në punë provuese.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj.mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti"Sh.A.Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 12.02.2021 deri më datën 27.02.2021. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 09.02.2021, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësim të vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 12.02.2021 të shpallë;

**KONKURS**

Për plotësimin e vendit të punës:

**Punëtor Sigurimi - me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi**

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Bënë sigurimin e objekteve, të pasurisë dhe personelit në ndërmarrje;
- Mban evidencën nga rrethëveprimi i punëve dhe detyrave në ditarin e tij të punës;
- Shpërndan të gjitha llojet e vendimeve të administratës sipas kërkesës dhe urdhërit nga udhëheqësi drejtpërdrejtë si dhe kryen edhe punë tjera të kësaj lëmie;
- Për punën e tij i përgjigjet Përgjegjësit të sigurimit.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme ;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 3 muaj);
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj.mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti"Sh.A.Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 12.02.2021 deri më datën 27.02.2021. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Prof.Asoc.Dr.  
**SHKELQIM  
MILLAKU**  
**54**

**RAMUSHI 2021**  
PËR PRESIDENT

**FORÇA E KOSOVËS**



ALIANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS  
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVO



#PDK134

**69**

**Safete MALIQI**  
**QORMEMETI**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



#PDK134

**Ramë**  
**VATAJ**

**25**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



#PDK134

**83**

**Bujar  
KUKLECI**

#Rimëkëmbje  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

#PDK134  
**8 Bajrush  
Xhemali**  
#Rimëkëmbje  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

**Shteti.  
Shtet.**

**44**  
**Jetlir  
Zyberaj**

 **135**

**5** **BESNIK TAHIRI**  
\* \* \* \* \*  
**FORÇA E KOSOVËS**

**127**

**SHQIPE MEHMETI SELIMI**

**10**

**#krejtdhedrejt**

**ROYAL CROWN**  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Fumada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zuloa C.JSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

**MEKA**  
HALAL FOOD

**pashtetë pule**

**çilësi e garantuar**

pa konservues



#PDK134

**Hisen  
BERISHA** **53**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

**PDK 134**



**Prof. Dr. Bekim HAXHIU  
KAMISHI** **109**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



#PDK134

**1**

**Enver  
HOXHAJ**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



**121 NISMA**  
SOCIALDEMOKRATE

**ME  
ÇLIRIMTARËT!**

**11 BEKIM BRESTOVCI**